



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.849/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Gyltene Sylejmani kryesuese, Zyhdi Haziri dhe Adnan Konushevci anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arieta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Nenad Cvetkovic kandidat për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, nga radhët e subjektit politik G.I. Narodna Sloga, me seli në Partesh, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i parashtruar nga Nenad Cvetkovic kandidat për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, nga radhët e subjektit politik G.I. Narodna Sloga, me seli në Partesh, me shenjë ZL.Anr.849/2017 të datës 10.11.2017, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve(KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 10.11.2017, nga Nenad Cvetkovic kandidat për kryetar të Kuvendit Komunal në Partesh, nga radhët e subjektit politik G.I. Narodna Sloga, me seli në Partesh, i cili në apelin e tij pretendon se Lista Serbe ka manipuluar me të hollat më të cilat ka blerë votat dhe ka dhënë ryshfet qytetarëve të Komunës së Parteshit që të votojnë për kandidatet e Listës Serbe për anëtar të Kuvendit Komunal të Parteshit. Parashtruesi i apelit nga dëshmitë e dorëzuara thekson se shihet qartë korrespondimi në mes kandidatës për anëtare të Kuvendit Komunal në Partesh nga lista serbe, Milijana Jancic, se si ajo e rregullon shitblerjen e votave me qytetarët e Parteshit dhe se si në këtë manipulim janë përfshirë edhe bashkëshorti i sajë Momcilo Jancic dhe pronari i këmbimorës Novica Susic. Këta persona janë arrestuar nga Policia dhe nga ana e Prokurorit është iniciuar procedura penale ndaj tyre. Parashtruesi i apelit kërkon e anulimin e mandatit të kandidatës Milijana Jancic dhe Violeta Stojkovic si dhe diskualifikimin e tërë listës së anëtarëve për Kuvend Komunal të Listës Serbe në Komunën e Parteshit.

Apeluesi në mbështetje të pretendimeve të tij në apel ka bashkangjitur korrespondencat e bisedës në rrjetin social në Facebook të datës 07.11.2017 në mes të Milijana Jancic dhe Violeta Stojkovic.

KQZ në përgjigjen në apel të datës 11.11.2017, ka theksuar se Qendra e Numërimit të Rezultateve (QNR), pasi që pranon materialet zgjedhore sensitiv dhe josensitiv të cilat dorëzohen nga KVV dhe KKZ, bënë verifikimin, hetimin dhe auditimin e tyre dhe në momentin kur rastet nga vendvotimet ku konstatohet se ka shpërputhje të rezultatit zgjedhor dhe mospërputhje në mes FRP-ve dhe FRK-ve, i rekomandon KQZ-së për rinumërim apo anulim të atij rezultati për vendvotimet e caktuara. Andaj, në momentin e pranimit dhe verifikimit të materialit zgjedhor për Komunën e Parteshit nuk ka pasur arsye për anulim të rezultatit zgjedhor.

PZAP-i, pas shqyrtimit të bazueshmërisë së apelit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në apel gjeti se pretendimet e parashtruesit të apelit janë të pabazuara për faktin se provat e bashkangjitura në apelit nuk paraqesin referencë ligjore për marrjen e vendimit në favor të apellesit pasi që nga provat në lende, konkretisht nga mesazhet e këmbjeryera në rrjetin social Facebook, nuk mund të identifikohen personat që kanë këmbjeryer mesazhe dhe në çfarë cilësie kanë pasur ata. Nga përmbajtja e mesazheve të këmbjeryera nuk rezulton se për cilët kandidate për anëtarë të Kuvendeve Komunale dhe të cilit subjekt politik, duhet të votohet. Prandaj, paneli ka kërkuar edhe nga policia raport lidhur me hetimin e rastit me qëllim të vërtetimit të faktit se a ka pasur shpërblim financiar që ka ndikuar të votuesit, mirëpo në raportin e policisë, të dhënë me datën 1.11.2017 nuk është dhënë asnjë informacion lidhur me rastin konkret.

Andaj paneli vlerëson se pretendimet në apel janë të përgjithësuara dhe të pa argumentuar me fakte dhe si të tillë jo bindëse pasi që nuk i plotësojnë kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht PZAP-i, në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në apel, konstaton se apeli në fjalë është i pabazuar dhe i pa argumentuar, dhe si të tillë apelin e refuzoj.

Nga sa u tha më lartë, në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.849/2017 më datën 12.11.2017



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*